



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MEMALIAJ  
DREJTORIA E SHERBIMIT SOCIAL**

Nr 484 Prot

Memaliaj, më 17/02 /2026

**PROJEKT- VENDIM  
PËR MIRATIMIN E PAGESËS MUJORE TË FATURAVE TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE DHE UJIT PËR ZNJ.YLEMA DULAJ**

**Këshillit BASHKIAK  
MEMALIAJ**

Kwshilli bashkiak Në mbështetje të:

- Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
  - Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- paraqitet për shqyrtim dhe miratim ky relacion:

Shtetasja Ylema Dulaj është kryefamiljare, me dy fëmijë të mitur, dhe përfituese e bonusit të qirasë miratuar me VKB nr 7, date 27.01.2025 “Per miratimin e listes emerore per vleren maksimale te subvencionimitte qirase ne treg te lire 2025”, e kategorizuar si familje në nevojë. Nga verifikimi i kryer nga strukturat përkatëse të Bashkisë rezulton se familja ndodhet në vështirësi të theksuara ekonomike dhe nuk është në gjendje të përballojë shpenzimet bazë jetike, përfshirë pagesën mujore të faturave të energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm.

Mosshlyerja e këtyre detyrimeve rrezikon ndërprerjen e shërbimeve bazë, duke cenuar kushtet minimale të jetesës dhe mirëqenien e fëmijëve të mitur, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes sociale dhe interesin më të lartë të fëmijës.

Në këto kushte, propozohet që Bashkia të mbulojë çdo muaj faturat e energjisë elektrike dhe ujit për shtetasen Ylema Dulaj, për sa kohë që ajo vazhdon të jetë e kategorizuar si familje në nevojë, në përputhje me mundësitë buxhetore dhe aktet ligjore në fuqi.

**Për sa më sipër,**

**PROPOZOJME:**

- 1.Miratimin e pagesës mujore të faturave të energjisë elektrike dhe ujit për shtetasen Ylema Dulaj kryefamiljare me dy të mitur.
- 2.Ngarkohet Drejtoria e Finances per zbatimin e ketij vendimi.

**Konceptoi :Laora Hoxha**

